

VENDIM
Nr. 911, datë 22.12.2014

PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN “RSM”, NË SHTABE TË NDRYSHME TË NATO-S, NË AFGANISTAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin me mision të personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të përbërë nga 11 (njëmbëdhjetë) ushtarakë, në shtabe të ndryshme të NATO-s, në Kabul dhe Herat, Afganistan, si më poshtë vijon:

Në Shtabin e Resolute Support Mission (RSM HQ), në operacionin “RSM”, në Kabul, Afganistan:

- Numri i pjesëmarrjes, 3 (tre) ushtarakë;
- Venddislokimi, Kabul, Afganistan.

Në Shtabin e Trajnim - Këshillimit dhe Ndihmës (TAAC - Capital), në operacionin “RSM”, Kabul, Afganistan:

- Numri i pjesëmarrjes, 4 (katër) ushtarakë;
- Venddislokimi, Kabul, Afganistan.

Në Shtabin e Operacioneve të Forcave Speciale të NATO-s (NSOCC-A), në operacionin “RSM”, në Kabul, Afganistan:

- Numri i pjesëmarrjes, 2 (dy) ushtarakë;
- Venddislokimi, Kabul, Afganistan.

Në Shtabin e Trajnim - Këshillimit dhe Ndihmës në (TAAC-West), në operacionin “RSM”, në Herat, Afganistan:

- Numri i pjesëmarrjes, 2 (dy) ushtarakë;
- Venddislokimi, Kabul, Afganistan.

2. Misioni i personelit, që do të marrë pjesë në shtabet e sipërpërmendura, është mbështetja dhe dhënia e kontributit në funksione të ndryshme në shtabet e trajnimit, këshillimit dhe dhënies së ndihmës, në operacionin e NATO-s “RSM”, Afganistan.

3. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri në 5 (pesë) vjet, afat i cili fillon të llogaritet nga data e dërgimit të përfaqësuesit të parë në Afganistan. Periudha e qëndrimit në mision për çdo përfaqësues do të jetë me sistem rotacioni në çdo 6 (gjashtë) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me kontingjentin e radhës (marrjen dhe dorëzimin e detyrës, vonesa të transportit strategjik). Për postet Crisis Establishment (CE) që plotësohen nga oficerë me gradën “Kolonel”, rotacioni të jetë 1 (një) vit.

4. Ministria e Mbrojtjes, për ushtarakët pjesëmarrës në këtë operacion, të përballojë shpenzimet për:

- a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;
- b) sigurimin e jetës;

- c) siguracion shëndetësor jashtë zonës së operacionit;
 - ç) mbështetje shëndetësore;
 - d) shpenzime për telefon, internet dhe shërbime postare;
 - dh) transport;
 - e) transportimin e individëve të shkëputur nga misioni për në atdhe në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline;
 - ë) aktivitete social - kulturore në rastet e festave kombëtare, gjatë kohës së kryerjes së misionit;
 - f) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.
5. Transporti i personelit që do të shërbejë në Afganistan, ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën për t'u kthyer në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, lavanteria të përballohet nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, me përjashtim të rasteve kur do të arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dy - ose shumëpalëshe ku pala tjetër merr përsipër të përballojë këto shpenzime.
6. Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet për ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët do të marrin pjesë në këtë mision.
7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.
8. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama